



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 26011 Prot.

Roskovec, më 30.03.2022

Procesverbal Nr.3

-I mbajtur sot, date 29.03.2022, ora 14, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shkurt 2022.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-28 Shkurt 2022.
5. Për miratimin e raportit për vendimmarrjen, performancën dhe transparencën e Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2021.
6. Për një shtesë në Vendimin Nr.93 datë 25.11.2021 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2022”.
7. Për miratimin e taveve përgatitore të PBA 2023-2025.
8. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022.
9. Informacion mbi respektimin e kuotave gjinore nga administrata e bashkisë për vitin 2021.
10. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 14⁰⁵

Keshilltaret prezent: A.Kola, V.Mata, E.Çepele, L.Hoxha, L.Goga, B.Kuka, D.Hoxha, K.Hyska, G.Hoxha, A.Sheme, H.Beqiraj, B.Toska.

Keshilltaret qemungojne :Rr.Hazizi, B.Çobo, T.Kuka, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, M.Sufka.

Prezent nga bashkia: Nenkryetari M.Goga, Dr.Juridike, Dr.Ardhurave Vendore, Dr.Ekonomise P/sek/Sherbimit Social, P/Biznesit.

Me plotesimin e kuorunit ,kryetari hap mbledhjen.Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 12 keshilltare.Para se te filloje me mbledhjen,kryetari u ben me dije se kemi nje informacion shtese i cili ka lidhje me analizen e prioriteteve te komunitetit per tavanet pergatitore te PBA 2023-2025,te cilen duhet ta fusim ne rendin e dites sot.E hedh ne votim informacionin per ta shtuar ne rendin e dites dhe miratohet unanimsht me 12 vota pro.Kryetari u ben me dije edhe disa problematika qe kane dal nga puna e keshillit,mungesat e keshilltareve ne mbledhje dhe problemi i orarit te

mbledhjes. Duke pare se kjo eshte nje situate e perseritur, sekretarja e keshillit ka bere nje shkrese drejtuar mua dhe Kryetares se bashkise ne lidhje me keto problematika. Sekretarja lexon shkresen duke vene ne dukje problematikat e konstatuara ne punen e keshillit. Theksi i kesaj shkrese eshte neglizhenca nga ana e disa anetareve ne marrjen pjese ne mbledhje, te cilen e kane detyrim ligjor. Lexi-pavaresisht kesaj, nuk ka pasur deshtim te mbledhjes. Ne e kemi te qarte rregulloren dhe detyrimin tone ligjor. Perderisa mbledhjet nuk kane deshtuar, puna e keshillit eshte per tu pershendetur. Kadriu-ti flet keshtu se vet je i rregullt, por ta dish ti ca heqim ne per te zhvilluar nje mbledhje, i mer sekretarja si me lutje per te ardhur ne mbledhje, i marr une apo nenkryetari qe te behet numri, prandaj mbledhjet nuk kane deshtuar. Elmazi-E degjova informacionin, deri me sot nuk ka pasur deshtim te mbledhjes. Une kam munguar vetem per arsye shendetesore. Jam dakort qe te respektojme rregulloret edhe ligjin, por keshilli ka ber nje pune te mire. Per orarin e kemi diskutuar disa here dhe u kemi dhene prioritet mesuesve meqe jane femra. Maksi-une i gjej ne vend problemet qe ka sjelle sekretarja. Fakti qe ne jemi ne limitet e numrit te keshilltareve, le vend per tu diskutuar. Marrjen pjese ne mbledhje pervec detyrimit ligjor e keni edhe detyrim moral. Serioziteti i punes se sekretares dhe kryetarit, ka vend per ta diskutuar kete problem. Disa here mbledhjet do kishin deshtuar, po te mos i kishim marr neve ne telefon si me lutje. Ju lutem tregohuni me te pergjegjshem sepse e keni detyrim dhe paguheni per kete dite. Ne te kundert do fillojme tju mbajme pagat. Per orarin hajt flasim ta zgjidhim. Viktori-ne mbledhjen e kaluar kerkova nje informacion por se kisha personale. Maksi-ky informacion do i sqarohet te gjithe keshilltareve, ndersa juve ua dhame fotokopje meqe e kerkuat mbledhjen e pare. Por informacioni do lexohet nga drejtoresha juridike ne fund te mbledhjes. Viktori-orari i mbledhjes te jete vetem paradite.

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites bashke me shtesen e bere si me siper dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Janar 2022.

Informacioni i pergatitur nga sekretarja ka te bej me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar, vendimet te cilat ishin akte normative dhe miratimi i tyre ne Prefektore. Nuk ka diskutime.

3. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

4. Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-28 Shkurt 2022.

Elmazi-nese qeveria nuk i ka rritur pagesat per mua eshte krim. Elisi-trajtimi ne fondin 6% eshte i limituar. Ne nuk dalim dot jashte vendimeve te qeverise. Elmazi-ata qe e kane kompetence per ta kerkuar ne qeveri, pse nuk po rritet akoma se kryeministri ka thene qe do rriten. Elisi-deri ne kete moment nuk na ka ardhur asnje lloj shkrese. Nenkryetari-paketa e emergjences fillon ne Prill deri ne Qershor. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

5. Per miratimin e raportit per vendimmarrje, performancen dhe transparencen e Keshillit te Bashkise Roskovec per vitin 2021.

Ky raport eshte pergatitur nga sekretarja e keshillit dhe ka lidhje me gjithe punen e keshillit per vitin 2021. Ne raport eshte evidentuar numri i mbledhjeve, numri total i vendimeve, i akteve normative, miratimi, numri i degjesave publike, performanca e keshillit etj. Ska diskutime. Hidhet ne votim raporti i vendimmarrjes, performances dhe transparences se Keshillit Bashkiak per vitin 2021 dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

6.Per nje shtese ne Vendimin Nr.93 date 25.11.2021 “Per miratimin e Paketes Fiskale per vitin 2022”.

Ditmira sqaron projektin.Ka te beje me nje tarife per mbrojtjen dhe permiresimin e mjedisit.Kjo tarife vjen ne baze te nje raporti i hartuar nga ekspertja e mjedisit e pavarur dhe grupi i punes i ngritur nga bashkia.Ditmira sqaron konkluzionet dhe gjetjet e raportit te hartuar.Nga raporti del se keto subjekte dhe aktiviteti i tyre ka nje impakt negativ ne mjedis.Per zbutjen e ketyre ndikimeve ne mjedis bashkia ka hartuar edhe disa projekte me vlerat perkatese,te cilat do te zbusin situaten e krijuar.Leksi-kemi bere disa here degjesat publike me grupet e interesit.A kane rene dakort grupet e interesit,qe ne mos te kemi gjyqe me vone?Ditmira-deri sot nuk na kane derguar kundershime grupet e interesit.Aleksander-jam shume dakort per Bankersin dhe Albpetrolin,por per karburantet dhe gomisterite nuk mendoj se sjellin aq ndotje,duhet ta rishikojme.Tek pjesa e fabrikave jam dakort sepse ndihet ndotja tek pjesa nga kemi tokat.Ditmira-gomisterite ndikojne ne mjedis.sepse derdhin vajra ne kanale,dhe shkaktojne me teper impakt dhe ndotje sesa nje arome e pakendeshme.Maksi-ka diferencim ne tarife ne baze te nivelit te ndotjes.Aleksander-per ndotje,keni edhe furrat e bukes qe shkaktojne ndotje ne mjedis.Mund te kete edhe biznese te tjera.Elmazi-perderisa jane kompani qe punojne ne zonen tone,dhe gomisterite jane nje nga ndotesit me te mbedhenj.Nuk jam qe te perjashtohen asnje biznes nga ndotja,te jene te gjitha per perfshire nese e ndotin ambjentin.Genci-ti ke piken e skrapit ketu ne mes te qytetit qe shkakton shume ndotje,e kam ngritur disa here.Kryetari-do ti kene parasysh per ti shikuar keto qe ju ngritet.Viktori-me vjen shume mire qe i keni vendosur keto tarifa.Keto leke qe do mblidhen ku do hidhen? Se ne tokat qe kemi aty ne Marinez nuk i shfrytezojme dot,pra do kete ndonje impakt direkt ne mjedis leket qe do mblidhen?Maksi-do te behet nje brez i gjelbert,do te riparohen rruget.Alketi-ca distance duhet te kete nje objekt i ngritur nga toka bujqesore?Nga fabrikat e vajit qe bejne ndotje ka ndonje te gjobitur?Aleksander-dua qe te shikohen edhe bizneset e tjera qe shkaktojne ndotje.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit te paraqitur,nje shtese ne Vendimin Nr.93 date 25.11.2021 “Per miratimin e Paketes Fiskale per vitin 2022” dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

7.Per miratimin e tavaneve pergatitore te PBA 2023 – 2025.

Dr.finances S.Çepele sqaron projektin.Risi per kete periudhe PBA jane thjeshtuar programet dhe jane bere 20.Sqaron programet te ndara ne vlerat perkatese,per bashkine Roskovec dhe 2 njesite shpenzuese sipas formateve C1 dhe D1.Kryetari u ben me dije se informacioni qe futem shtese ne fillim te mbledhjes “analiza e prioriteteve te komunitetit per tavanet pergatitore te PBA 2023-2025” ka lidhje me kete projekt.Kjo analize ka dal ne baze te nje sondazhi qe ka qene online rreth 1 muaj dhe do te vazhdoje akoma te qendroje online,deri para tavaneve perfundimtare.Hidhet ne votim miratimi i tavaneve pergatitore te PBA 2023-2025 dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

8.Per miratim rishperndarje fondesh ndermjet programesh ne buxhetin e bashkise Roskovec per vitin 2022.

Dr.finances sqaron projektin dhe rishperndarjen e fondeve ndermjet programeve.Leksi-Memoriali ku eshte?ky ketu afer bashkise?Pergjigja eshte po.Shtohet fondi per funizim dhe vendosje te dy statujave tek memoriali dhe muzeu Roskovec.Sqaron edhe fondet qe pakesohen sipas materjalit.Nuk ka diskutime.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimisht ne 12 vota pro.

9.Informacion mbi respektimin e kuotave gjinore nga administrata e bashkise per vitin 2021.

Delina-eshte nje informacion qe na ka ardhur nga bashki te forta.Bashkia jone i ka respektuar kuotat gjinore te perfaqesimit per secilen gjini.Nenkryetari-jemi nder bashkite me te mira ne vend qe e kemi respektuar kuoten gjinore sipas ligjit.

10.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Delina sqaron keshilltaret ne lidhje me kontratat e tokes se dhene me qera,dhe qe aktualisht jane aktive,jo per ato qe i ka mbaruar afati.Viktori-sa eshte siperfaqja totale e dhene me qera?Delina-siperfaqen e ke per cdo kontrate te lidhur sipas informacionit qe ju keni.Delina sqaron kontratat perkatese,emrat perkates dhe siperfaqet e tyre.Viktori-personat qe kane marr toke me qera,ca aktiviteti kane dhe ca taksash paguajne?Delina-ata kane marr me qera toke bujqesore,nga informacioni qe kemi keta nuk jane debitor ne lidhje me pagesen e taksave.Viktori-kam pershtypjen se eshte shume siperfaqe e madhe,por problemi qe ngre eshte nese paguajne ose jo taksa?Genci-keta qe kane marr toke me qera,duhet te jene nga bashkia Roskovec apo edhe nga zonat e tjera?Delina-perfiton cdo i interesuar qe ben kerkese dhe ploteson kushtet.Elmazi-ne mbledhjen e meparshme kam ngritur disa problematika,duhet te na informoni ne mbledhjen vijuese se ca eshte bere me problemet qe ne ngreme.Ngrita problemin e sinjalistikes dhe tabelave,te na raportoni kur fillon mbledhja.Maksi-te gjitha problemet qe ju ngrini na i sjell sekretarja me shkrese,i eshte dhene detyra sektorit perkates per ta zgjidhur kete problem.Leksi-problemi i ujit tek varrezat ne Roskovec.Kryetari-dhe ne Vlosh eshte ky problem.Leksi-problemi i energjise elektrike,te vihet gjeneratori ne funksion,se kur mungojne dritat zyrtat nuk punojne dot.Leksi-ne kemi ngritur disa here probleme,na raportoni nese i merrni parasysht apo jo.Kryetari-informacion ne mbledhjen e ardhshme sa hektar pyje ka bashkia dhe a jane te certifikuara?Informacion per token ne Çerven qe e kane Siqecallaret,a paguajne taksa ne bashki?Territori qe kane qene magazina shteterore dhe trualli ne Vlosh i magazinave te ish koperatives bujqesore,kush e disponon tani,e ka bashkia te certifikuar?Jane 50 hektar toke e pandare ne Vlosh,a merret takse per kete toke?Informacione te kerkuara per mbledhjen e ardhshme.Viktori-kur u nda toka shkolles ne Marinez i eshte lene ne dispozicion 5 hektar toke.Nuk e di nese e ka kete toke apo eshte ndare me komision me vone?Nenkryetari-ne lidhje me tokat qe disponojne shkollat brenda territorit te tyre,jane ne regjister te hedhura.Nenkryetari-ne lidhje me pyetjen e Leksit per gjeneratorin,ne e kemi blere gjeneratorin,na duhen vetem disa materjale te vogla per ta vene ne pune.Lumturi Hoxha-problemi i pastrimit te plehrave,nuk kemi kazan per te hedhur plehrat.Nenkryetari K.Lushka sqaron se kazanet do vijne shume shpejt,po i presim.Nuk ka me diskutime.Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Kadri Hyska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3612 Prot.

Roskovec, më 29, 04 2022

VENDIM

NR 74 .DATË 28 . 04 .2022

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN MARS 2022”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.03.2022, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Mars 2022.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska

